

URDHËR
Nr. 1421, datë 22.8.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të germës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, germës “c”, të pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për Kadastrën”, të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, në funksion të mbarëvajtjes së veprimtarisë administrative dhe zbatimit të detyrimeve të parashikuara në kuadrin ligjor në fuqi,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës z. Enis Hoxha, drejtori i Njesisë së Titujve të Pronësisë për sa vijon:
 - Për të nënshkruar shkresat informuese dalëse të Drejtorisë së Përgjithshme, pjesë e fushës së përgjegjësisë së Njesisë së Titujve të Pronësisë, që u drejtohen të tretëve (personave fizikë, personave juridikë, publikë apo privatë), si dhe ato drejtuar strukturave të varësisë të ASHK-së, dhe trajtojnë kërkesë-ankesat që i përkasin korrespondencës shkresore hyrëse të administruar në protokollin e Drejtorisë së Përgjithshme përpara datës 30.7.2024 dhe shpërndarë për ndjekje dhe trajtim nga titullari përpara kësaj date.
 - Përjashtimit shkresat që i drejtohen Presidentit të Republikës, Kuvendit, Kryeministrit, ministrave, Sekretarit të Përgjithshëm të Kryeministritë/ministrive, Avokatit të Popullit, Prefektut si dhe kryetarëve të bashkive nënshkruhen nga drejtori i përgjithshëm.
 2. Pavarësisht delegimit të kompetencës sipas këtij urdhri, drejtori i Njesisë së Titujve të Pronësisë nëse e gjykon të nevojshme, mund t'i përcjellë për miratim drejtorit të përgjithshmen shkresat që i vlerëson të një rëndësie të veçantë.
 3. Delegimi i kompetencës sipas këtij urdhri nuk përfshin aktet administrative dhe detyrat të cilat duhet të miratohen dhe të ushtrohen nga drejtori i përgjithshëm, në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 111/2018, “Për Kadastrën”.
 4. Delegimi i kompetencave sipas përcaktimit të bërë në pikën 1 të këtij urdhri, bëhet për t'u ushtruar nga drejtori i Njesisë së Titujve deri në përmbylljen e procesit të trajtimit dhe përcjelljes së korrespondencës shkresore sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1 të këtij urdhri.
 5. Në rast mungese në detyrë të drejtorit të Njesisë së Titujve të Pronësisë, delegimi i kompetencës konsiderohet i ndërprerë për periudhën e mungesës në kuptim të nenit 29, pika 2, germa “c”, të Kodit të Procedurave Administrative. Gjatë mungesës, kompetenca ushtrohet nga drejtori i përgjithshëm.
 6. Pas përmbylljes së detyrimeve, sipas përcaktimeve të pikës 4 të këtij urdhri, delegimi i kompetencave quhet i përfunduar.
 7. Ngarkohet Njësia e Titujve të Pronësisë dhe drejtori i tyre dhe Sektori i Arkiv-Protokollit në Drejtorinë e Përgjithshme për zbatimin e këtij urdhri.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Lorena Goxhobelli